

VENDIM
Nr. 244, datë 30.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË
MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Punëve Brendshme, të ministrit të Financave dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në titull dhe në përmbajtjen e vendimit, emërtimi “Ministria e Brendshme” zëvendësohet me “Ministria e Punëve të Brendshme”.

b) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikat e reja të pagave për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES TË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmëspecialist në provë në trupën operacionale	44500	9000
2	Agjent	Ndihmëspecialist në trupën operacionale	49000	9000
3	Agjent i I-rë	Drejtnes grupi/ Ndihmës specialist në trupën operacionale	54500	9000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor. Specialist hetimi në nivel vendor në provë	65000	8000
5	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel vendor	77000	8000
	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel qendror Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	82000	10000
6	Drejtnes	Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror	88000	10000
7	Drejtnes i I-rë	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	99000	10000
8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të hetimit).	102000	15000
9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	111000	20000